

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës	Menaxhimi i Dijes
Niveli	Bachelor
Statusi i lëndës	Zgjedhore
Viti i studimeve	II
Semestri	III
Numri orëve në javë	3
Vlera në kredi - ECTS	4
Koha / lokacioni	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës	
Detajet kontaktuese	
Përshkrimi i lëndës	Zhvillimi historik i menaxhimit të dijes, Konceptet themelore të dijes dhe kreativitetit, modeli i rritjes së dijes, shkaqet e ekspansionit të dijeve, kuptimi i menaxhimit të dijes, dimensionet e menaxhimit të dijes, menaxhimi i rrjedhjes së dijes, mjetet për menaxhimin e diturisë, ndërtimi i kornizës së menaxhimit të dijes në organizate, kapitali intelektual, ekonomia e dijes, ndërmarrjet që mësojnë dijen, Dituria si shtyllë kryesore për zhvillimin ekonomik, transferi i diturisë, transferi i brendshëm dhe ai i jashtëm i diturisë, Roli i dijes dhe teknologjisë informatike në krijimin e produkteve dhe shërbimeve të reja.
Qëllimet e lëndës	Qëllimi kryesor i këtij moduli është të kuptuarit (nga studentet) e parimeve kryesore të menaxhimit të dijes në funksion të inovacioneve, po ashtu ta aftësojë studentin me dituri të mjaftueshme që të menaxhojë proceset e zhvillimit të BNJ në organizata, si dhe ta bejë transferimin e dijes brenda dhe jashtë organizatave.
Rezultatet e pritura të mësim nxënies	Studentët pas përfundimit të këtij moduli studentet do të jenë në gjendje të: 1. Kuptojnë se si bizneset moderne përballen me sfidën e ekonomisë së bazuar në njohuri. (ECTS 0.5), 2. Të jenë kompetentë të përdorin mjete dhe teknika të menaxhimit të njohurive. (ECTS 0.5), 3. Zhvillojnë aplikacione për menaxhimin e njohurive në organizata. (ECTS 0.5), 4. Përfitojnë njohuri për të krijuar ide të reja biznesore, (ECTS 0.5), 5. Shfrytëzojnë idetë biznesore në zgjidhjen kreative të problemeve si dhe në komercializimin e inovacioneve, (ECTS 0.5), 6. Identifikojnë rolin e dijes në raport me teknologjinë informative në funksion të zgjerimit të biznesit, (ECTS 0.5), 7. Të jenë kompetent për të qenë pjesë e ekipit në ndërmarrje në funksion të aplikimit të dijes në biznes, (ECTS 1),

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren			
Kollokiume – seminare			
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			25
Përgatitja përfundimtare në provim	3	2	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies (dhe mësimnxënies)	Ligjërata dhe ushtrime të kombinuara me raste të studimit dhe diskutime në klasë.		
Metodat e vlerësimit (kriteret e kalueshmërisë)	Metoda e vlerësimit – mbështetet në tri aktivitete – në baze të të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: ➤ Provimi final.....max 100 pikë (%), Kriteret e kalueshmërisë - ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit: 1. Testi i provimit final, vlerësohet me 100 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme, Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuar nga senati i Universitetit. Testi i provimit (formular i pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studentit dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban: ♦ pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.....40 pikë (%), ♦ pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studentit duhet të jete në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjëruar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit.....60 pikë (%)		

	Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësim-nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike. Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit, Notat në UShAF: <table><tr><th>Nota</th><th>ECTS/Nota</th><th>Përqindja (%)</th><th>Përkufizimi</th></tr><tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr><tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr><tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr><tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr></table>	Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm	8	C	70 - 79	Shumë mirë	7	D	60 - 69	Mirë	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi																										
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm																										
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm																										
8	C	70 - 79	Shumë mirë																										
7	D	60 - 69	Mirë																										
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm																										
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm																										
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi Tabela inteligjente, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, etj.																												
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	60% - Teori, 40% - Ushtrime/detyra praktike, Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulën e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (vizita praktike, ushtrime me studentë, kuize studentore në klase, etj). Nga gjithsej 100 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 60% me fokus në teori dhe 40% në ushtrime/detyra praktike. • 60 orë janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara në modulën e lëndës. • 40 orë janë të fokusuar në ushtrime/detyra praktike, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektsh simulimi. Ndarja e 4 ECTS sipas raportit 70%-30% ❖ 2.4 ECTS - i dedikohen pjesës teorike, ❖ 1.6 ECTS - i dedikohen pjesës ushtrime/detyra praktike, Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.																												
Literatura																													
Literatura bazë	1. Jashopara A (2011): Knowledge Management: An integrated approach, 2ed, Prentice Hall ISBN 978-0-273-72685-2. 2. Rhem, Anthony J (2016) Knowledge management in practice																												
Literatura shtesë	1. Hall, Richard (2009): Knowledge Management in the New Business Environment, acirrt, University of Sydney, 2003 2. Davenport T., Prusak L.: Working Knowledge: How organizations manage what they know, Harvard Business School Press, 2010. -Authorized lectures																												
Informacione shtesë:																													

Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantimi Syllabusit Hyrje në Menaxhimi i dijes Rezultati nr. 1.
Java e dytë	Zhvillimi historik i menaxhimit të diturisë Rezultati nr. 1 dhe 2.
Java e tretë	Dituria dhe zhvillimi i prodhimit Rezultati nr. 2.
Java e katërt	Modeli i rritjes së dijes, shkaqet e ekspansionit të dijeve Rezultati nr. 2 dhe 3.
Java e pestë	Kuptimi i menaxhimit të dijes Diskutime interaktive, Rezultati nr. 2.
Java e gjashtë	Dimensionet e menaxhimit të dijes Rezultati nr. 3 dhe 4.
Java e shtatë	Menaxhimi i rrjedhjes së dijes mjetet për menaxhimin e diturisë Diskutime interaktive, Rezultati nr. 5.
Java e tetë	Kapitali intelektual, ekonomia e dijes, Rezultati nr. 5 dhe 6.
Java e nëntë	Ndërtimi i kornizës së menaxhimit të dijes në organizate Rezultati nr. 1.
Java e dhjetë	Ekonomia e dijes, Diskutime interaktive, Rezultati nr. 4, 5 dhe 6.
Java e njëmbëdhjetë	Ndërmarrjet që mësojnë dijen, Rezultati nr. 7.
Java e dymbëdhjetë	Dituria si shtyllë qendrore për zhvillimin ekonomik, Diskutime interaktive, Rezultati nr. 6 dhe 7.
Java e trembëdhjetë	Transferi i diturisë Rezultati nr. 6.
Java e katërbëdhjetë	Transferi brendshëm dhe ai i jashtëm i diturisë Diskutime interaktive, Rezultati nr. 7.
Java e pesëmbëdhjetë	Roli i dijes dhe teknologjisë informatike në krijimin e produkteve dhe shërbimeve të reja, Rezultati nr. 5, 6 dhe 7.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes

Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësuesi ka të drejtë t'i kërkojë studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.